



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 775/17, Prot.

Tiranë, më 15/12/2017

V E N D I M

Nr. 171, Datë 15/12/2017

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË DURRËS "MBI
AUDITIMIN E RREGULLSHMËRISË FINANCIARE TË
AKTIVITETIT EKONOMIK NGA DATA 01.01.2016 DERI ME DATË
31.12.2016"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori dhe Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi financiar i ushtruar në Bashkinë Durrës janë konstatuar parregullsi, devijime materiale por jo të përhapura, për të cilat jemi shprehur në Raportin e Auditimit bashkëlidhur, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin financiar të Pasqyrave Financiare të vitit 2016" të ushtruar në Bashkinë Durrës, sipas programit të auditimit nr. 775/4 prot, datë 24/08/2017 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion i kualifikuar

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200² shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Durrës, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i audituar (Bashkia Durrës) mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për aspektet mbi të cilat gjykojmë për modifikimin e opinionit tonë. Jemi të pasigurt për disa çështje të pazakonta të konstatuara, të cilat janë materiale, dukshëm mbi nivelin e materialitetit, me ndikim në vendimmarrjen e përdoruesit të pasqyrave financiare:

1. Në llogaritë "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" është pasqyruar pa të drejtë vlera **393,668,493 lekë**, e cila përfaqëson disponibilitete në Degën e Thesarit, të mundshme për t'u përdorur, por meqenëse janë Grande Konkurruese *me kusht* nuk janë disponibilitete të Bashkisë. Në këtë mënyrë është *zmadhuar* pa të drejtë llogaria "Fonde të veta".
2. Në çelje të Pasqyrave Financiare të vitit 2016, nuk është pasqyruar fondi i grandit të kushtëzuar i përdorur deri në 31.12.2015 në vlerën 443,035,974 lekë (investime shtesë), duke mos reflektuar nivelin real të investimeve. Gjithashtu nuk është pasqyruar vlera e investimeve në proces nga fondet e Bashkisë në fund të vitit 2016 në vlerën 649,715,870 lekë, në total **1,092,751,844 lekë**.
3. Aktivitetet e Patrupëzuara, me vlerë historike 254,133,413 lekë, aktualisht kanë një vlerë negative prej -20,837,452 lekë, e cila ka ardhur si pasojë e një veprimi të dubluar të amortizimit lidhur me këtë grup aktivi. Ky gabim tregon një fakt të rëndësishëm, mungesën e kontrolleve mbi regjistrimet kontabël dhe sidomos veprimet e mbylljes së llogarive vjetore.
4. Në fushën e programimit dhe zbatimit të buxhetit, u konstatua mungesë në saktësinë e paraqitjes së shpenzimeve për investime në Pasqyrat Financiare, konkretisht mangësi në Formatin 4, të Pasqyrave Financiare, mbi "Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, viti 2016". Nuk janë evidentuar në zërin 232 "Transferime Kapitale", aktive në vlerën **888,684,131 lekë**, si pasojë kjo llogari ka dalë në bilanc me gjendje negative prej - 514,564,116 lekë të kësaj llogarie. Një fakt i

¹Objektivi i audituesit është të formulohet një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

²Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

tillë nuk ka tërhequr vëmendjen e hartuesve por dhe të përdoruesve të këtyre pasqyrave duke reflektuar një nivel njohje të raportimit financiar mjaft të ulët në të gjitha nivelet e hierarkisë.

5. Nga të dhënat e marra pranë Drejtorisë së Tatim Taksave, Sektori i Borxhit konstatojmë se vlera e paraqitur në pasqyrat financiare për detyrime të pambledhura nga tatimet dhe taksat vendore është e gabuar pasi nuk ka përfshirë debitorë të ardhur nga ish Komunat, të cilët nuk janë hedhur në sistem. Vlera e pa kontabilizuar është 4,817,129 lekë ku përfshihen debitorë të çregjistruar ndonëse kanë detyrime në vlerë 3,318,259 lekë, si dhe të natyrës së pasaktësisë së të dhënave për 1,498,870 lekë.

6. Në llogarinë “Shpenzime te periudhave te ardhshme” me vlerë 405,544,337 lekë, në klasën 467 "Kreditorë të ndryshëm" janë përfshirë Vendime Gjyqësore për vlerën 37,224,835 lekë, kreditor të mbartur nga komunat për vlerën 170,808,546 lekë dhe kreditor gjyqësor nga investimet për vlerën 197,510,956 lekë. Kreditorë të mbartur nga komunat janë evidentuar nga sektori i buxhetit për këtë qëllim nga Bashkia Durrës. Praktikant kanë evidenca nga ish Njësitë Vendore (Bashkitë/Komunat) dhe verifikime janë bërë nga sektori i buxhetit. Të dhënat mbi kreditorët e komunave janë edhe në thesar, ku evidentohet shuma e detyrimit dhe shuma e shlyer. Nga Bashkia Durrës nuk është bërë rakordimi më të dhënat e thesarit për këtë shumë të pashlyer, duke rritur pasigurinë në vlerën e kësaj llogarie.

B. MASA ORGANIZATIVE

GJETJA 1

Në rregulloren e brendshme të funksionimit të Bashkisë, bazuar në ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore”, nuk është bërë një ndarje e detyrave funksionale, brenda Sektorit të Financës, duke mos shprehur qartë detyrat funksionale të secilit. Sidoqoftë nga Shefi i Sektorit të Financës është bërë një ndarje brenda sektorit mbi përgjegjësitë që ka specialisti i financës. Kjo ndarje nuk mbështetet nga Rregullorja e Brendshme dhe nuk përcakton detyrat e secilit specialist.

REKOMANDOJMË

Bashkia Durrës të marrë masat për të saktësuar plotësuar Rregulloren e Brendshme të funksionimit duke evidentuar detyrat e secilit specialist të financës dhe duke eliminuar mbivendosjen e detyrave të cilat shmangin edhe përcaktimin e përgjegjësiave konkrete për ndjekjen dhe regjistrimin e transaksioneve financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë

GJETJA 2

Në auditimin e kryer, u konstatua se ndonëse ekzistonte Regjistri i Riskut të plotësimit të objektivave të Bashkisë, ai kishte të përfshirë në nivel të pamjaftueshëm të detajimit të riskut, duke mos përfshirë të gjithë funksionet e bashkisë që janë shtuar si pasojë reformës si mbrojtja kundër zjarrit e shpëtimit, administrimi i pyjeve, sistemi i kullimit, rrugët rurale dhe arsimit parashkollor. Regjistri i riskut kishte në përmbajtje vetëm vlerësime për risqe të jashtme dhe të brendshme dhe nuk i detajon ato sipas objektivave të institucionit dhe strukturës së tij organizative dhe funksionale.

REKOMANDOJMË

Nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive përkatëse për vitin 2017, të realizohet detajimi i regjistrit të riskut i ndarë në komponent që lidhen me përmbushjen e detyrave nga secila drejtori në funksion të objektivave të institucionit.

Menjëherë

GJETJA 3

Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet, mbajtja e kontabilitetit dhe përpilimi i pasqyrave financiare realizohet me program Office Excel dhe jo me ndonjë software më të përshtatshëm. Kjo ul sigurinë e përpunimit të informacionit kontabël dhe rrit mundësinë për gabime dhe manipulime.

REKOMANDOJMË

Drejtoria Ekonomike të marrë masa për aplikimin e një program të përpunimit elektronik të kontabilitetit dhe përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Menjëherë

GJETJA 4

Nuk është bërë dokumentimi i saktë i transferimeve kapitale 1,726,715,203 lekë nga 2,476,216,528 lekë transferime totale, duke përcaktuar pjesën e plotë të investimit dhe pjesën që i takon çdo njësie vartëse. Kjo ndarje vlere duhet të ishte shoqëruar me akt-verifikime të karakterit teknik dhe inxhinierik, gjë që nuk është bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës, përcaktuar sipas rregullore së brendshme ku cilësohet se "Menaxhon dhe monitoron investimet publike post – tender, të ndara sipas nëpunësve të cilët janë në përbërje të strukturës".

REKOMANDOJMË

Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës, të marrë masa për dokumentimin e transferimeve kapitale dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave

Menjëherë dhe në vijimësi

GJETJA 5

Në lidhje me evidentimi kontabël të detyrimeve të pa mbledhura nga tatimet dhe taksat vendore, në fund të periudhës konstatohet vlera 113,667 mijë lekë. Nga të dhënat e marra pranë Drejtorisë së Tatim Taksave, Sektori i Borxhit konstatohet se vlera e paraqitur në pasqyrat financiare është e gabuar pasi nuk ka përfshirë debitorë të ardhur nga ish Komunat, të cilët nuk janë hedhur në sistem. Vlera e pa kontabilizuar është 4,817,129 lekë ku përfshihen debitorë të çregjistruar ndonëse kanë detyrime në vlerë 3,318,259 lekë, si dhe të natyrës së pasaktësisë së të dhënave për 1,498,870 lekë. Për këto subjekte nga DTTV nuk është bërë informimi i Drejtorisë Ekonomike si dhe i Sektorit të Financës, fakt që reflekton nivel të ulët bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Bashkisë.

REKOMANDOJMË

Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa për reflektimin në pasqyrat financiare të debitorëve të mbartur nga ish Njësitë Vendore (Bashkitë/Komunat) dhe të pa hedhur në sistem të DTTV, Bashkia Durrës, për vlerën **4,817,129 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

GJETJA 6

Asetet e Patrupëzuara, me vlerë historike 254,133,413 lekë, aktualisht kanë një vlerë negative prej -20,837,452 lekë. Kjo vlerë negative ka ardhur si pasojë e efektit të dubluar të amortizimit edhe transferimit të asetit. Ky gabim kontabël lidhet me kontabilizimin e amortizimit në vlerën **127,629,452 lekë** ndërkohë që kemi transferim të aktiveve në njësitë vartëse me vlerë historike 147,341,413 lekë. Llogaritja e amortizimit edhe për aktive të cilat nuk janë në shfrytëzim nga Bashkia Durrës, ka sjellë këtë pozicion të gabuar të këtij grupi të aktiveve. Nga ana tjetër ky gabim reflekton nivel të ulët të njohjes së rregullave të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

REKOMANDOJMË

1. Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa që në Pasqyrat Financiare të vitit 2017 të bëhet korigjimi i veprimit kontabël të amortizimit shpjeguar më sipër.

2. Nëpunësi i autorizuar të marrë në analizë Aseteve të Patrupëzuara të investuara që nga viti 2002 që nuk janë vënë në shfrytëzim, duke qenë gjendje në këtë zë të pasqyrave të bashkisë. Në rast të konstatimit të mos vënies dot të shfrytëzim të këtyre asetëve, të nxirret përgjegjësia për investime të pajustificuara.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2017

GJETJA 7

Llogaria "Shpenzime proces për rritjen e AQT" në vlerën në fillim të vitit prej 393,668,493 lekë dhe në fund të vitit është 374,120,014 lekë, e detajuar në Aneksin VIII, përfaqëson disponibilitete në Degën e Thesarit, të mundshme për t'u përdorur, por meqenëse janë Grande Konkurruese *me kusht* nuk janë disponibilitete të Bashkisë.

REKOMANDOJMË

Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa që në bilancin e vitit 2017 llogaria 231 "Shpenzime proces për rritjen e AQT" për vlerën **374,120,014 lekë**, e cila përfaqëson Grande Konkurruese për t'u fituar me kusht për t'u përdorur në investime, të ketë një kundraparti të grupit Grante, sipas standardeve të kontabilitetit publik. Rregullimet kontabël të shoqërohen edhe me shpjegim të detajuar në shënimet e pasqyrave financiare.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2017

GJETJA 8

Në çelje të Pasqyrave Financiare të vitit 2016, fondi i Grandit të Kushtëzuar i përdorur deri në 31.12.2015, i investuar shtesë në investime prej 443,035,974 lekë, nuk është pasqyruar në çelje të ushtrimit. Ky veprim ka sjellë pasaktësi në zërin e aktiveve në proces për Bashkinë. Gjithashtu nuk është pasqyruar vlera e investimeve në proces

nga fondet e Bashkisë në fund të vitit 2016 prej 649,715,870 lekë, në total 1,092,751,844 lekë. Kjo vlerë ka *reduktuar* pa të drejtë llogarinë fonde të veta.

REKOMANDOJMË

Sektori i Financës në Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa që në aktivin e bilancit të vitit 2017 të bëhen rregullimet kontabël për gabimet e konstatuara lidhur me zërin e aktiveve në proces.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2017

GJETJA 9

Nga grupi i auditimit u auditua transferimi i mjeteve të transportit pjesë e Aseteve të Qëndrueshme në total në vlerën 888,684,131 lekë. Mjetet e përfituara nga transferimet totale të bëra gjatë vitit prej 2,476,216,528 lekë janë në vlerë 31,669,200 lekë. Për këto mjete u konstatua se transferimi është bërë me procesverbale ku nuk evidentohet vlera kontabile, vlera e mbetur në kontabilitet si dhe gjendja faktike e mjetit, numri i shasisë dhe nëse gjykohet ndonjë vlerësim i mundshëm nga komisioni i Bashkisë ose nga ndonjë ekspert i jashtëm. Ky fenomen i mos evidentimit të vlerës reale të asetëve është vënë re edhe në procesverbale të tjera të shoqërimit të mjeteve të transportit. Kjo ul sigurinë dhe vërtetësinë e pasqyrimit të kësaj vlerë në kontabilitet dhe në Pasqyrat Financiare.

REKOMANDOJMË

1. Drejtoria Ekonomike nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për përpilimin e procesverbaleve tip të evidentimit të asetit, sipas natyrës së tij, mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011.
2. Drejtoria Ekonomike nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa që për mjetet e transportit të transferuara në njësitë vartëse, në vitin 2016 në shumën 31,669,200 lekë të evidentohet kjo në Pasqyrat Financiare të njëjësive të vartësisë të Bashkisë Durrës.

Menjëherë

GJETJA 10

Si pjesë të reformës Bashkisë së Durrësit, i kanë kaluar në pronësi gjithsej 964 prona, nga të cilat vetëm 45 prona janë pajisur me dokumentin e pronësisë të regjistruar në ZVRPP-në Durrës. Duke qenë se këto prona nuk kanë vlerë kontabile, nuk janë pasqyruar në kontabilitet.

REKOMANDOJMË

Kryetari i Bashkisë Durrës nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për regjistrimin e pronave në ZVRPP Durrës, vlerësimin dhe pasqyrimin e tyre në Pasqyrat Financiare.

Menjëherë

GJETJA 11

Në llogarinë "Shpenzime të periudhave të ardhshme" me vlerë 405,544,337 lekë, në klasën 467 "Kreditorë të ndryshëm" janë përfshirë Vendime Gjyqësore për vlerën 37,224,835 lekë, kreditor të mbartur nga komunat për vlerën 170,808,546 lekë dhe kreditor gjyqësor nga investimet për vlerën 197,510,956 lekë. Kreditorë të mbartur nga komunat janë evidentuar nga sektori i buxhetit për këtë qëllim nga Bashkia Durrës. Praktikant kanë evidenca nga ish Njësitë Vendore (Bashkitë/Komunat) dhe

verifikime janë bërë nga sektori i buxhetit. Të dhënat mbi kreditorët e komunave janë edhe në thesar, ku evidentohet shuma e detyrimit dhe shuma e shlyer. Nga Bashkia Durrës nuk është bërë rakordimi më të dhënat e thesarit për këtë shumë të pashlyer, duke rritur pasigurinë në vlerën e kësaj llogarie. Sidoqoftë pasiguria kufizohet dhe nuk lidhet me mundësinë për të shlyer dy apo më shumë herë të njëjtën faturë, pasi këto të dhëna menaxhohen nga sistemi i thesarit.

REKOMANDOJMË

Drejtoria Ekonomike të marrë masa që për kreditorët e mbartur nga ish Njësitë Vendore (Bashkitë/Komunat), si pasojë e reformës territoriale, të bëhet rakordim me Degën e Thesarit për madhësinë e deklaruar në pasqyrat financiare të Bashkisë të shumës 170,808,546 lekë.

Menjëherë

GJETJA 12

Nga auditimi u konstatuar një numër i konsiderueshëm pasaktësish në përpilimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura në periudhën nën auditim.

REKOMANDOJMË

Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Durrës, duhet të rishikohen veprimet përmbyllëse dhe rregulluese të vitit 2016, duke i cilësuar si zona me risk jo plotësisht të mbuluara sipas gjykimit tonë. Gjithashtu duhet të korrigjohen veprimet e vitit 2017, pasi në auditimin e radhës do të rishikohen veprimet rregulluese për pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe veprimet e vitit 2017.

Menjëherë

GJETJA 13

Në auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2016, u vunë re difekte të konsiderueshme dhe se mungesa e kapaciteteve njerëzore ka sjellë mungesë të sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm me efekt në raportimin financiar.

REKOMANDOJMË

Duke i tërhequr vëmendje strukturave drejtuese të Bashkisë Durrës, rekomandohet përmirësimi i kapaciteteve raportuese dhe përmirësim të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R